

AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

**PËRGJIGJET E KËRKESAVE TË TESTIT
(SKEMA E VLERËSIMIT)**

Shkolla e mesme e përgjithshme (drejtimi shoqëror; drejtimi i përgjithshëm)

Sesioni I, 9 qershor 2008

Varianti A

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen disa orientime lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në prozë dhe një në tragjedi.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 kërkesa.

Në vlerësimin e esesë duhet pasur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të kërkesës, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe kërkesës, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni**, se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA I

Migjeni

“Historia e njenës nga ato”

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë

Pyetja 6 3 pikë

Model përgjigjeje: Ngjarja zhvillohet në një vend anonim, ku asgjë nuk ndodh, ku të mbyty monotonia, ku ngjarjet e vetme ndodhin në stacion. Ky është një vend që nuk tërheq asnjë vëmendje, një vend të harruar, me njerëz mediokër. Është një vend i vështirë dhe i ashpër për t’u jetuar.

2 pikë **Përrshkrimi:** nëse nxënësi shkruan në mënyrë të plotë thelbin e këtij vendi dhe thekson elemente të tilla si: monotonia, shkretia, varfëria dhe me mendësi të prapambetur (burrat në stacion dhe malësorja e ngarkuar), anonim, i vështirë dhe i ashpër për t’u jetuar.

dhe

1 pikë Nëse jep në mënyrë të pjesshme thelbin e këtij vendi.

- Ky është një vend i shkretë;
- Një vend monoton;
- Një vend i varfër;
- Një katund që don të quhet qytet;
- Një stacion automobili;
- Një vend pa emër (anonim);
- Vend i vështirë për t’u jetuar;
- Etj.

1 pikë **Funksioni artistik:**

- Jeta e njeriut në këto vise është po kaq e shkretë dhe monotone sa ky vend. Përgjigja e dhënë i referohet **fundit** të Lukes.
- Një vend i shkretë, pa ngjyra, monoton dhe një jetë e përfunduar në shkretë, në harrim.
- Parapërgatit lexuesin për fundin tragjik të Lukes.

0 pikë Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime dhe ide që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 7 1 pikë

Model përgjigjeje

Tabutë tematike që theu Migjeni janë:

- tema e prostitucionit;

- figura e malësore, e parë në një këndvështrim të ndryshëm nga ai i letërsisë së traditës;
 - marrëdhëniet njerëzore të ndërtuara mbi bazën e interesit, moralin e gënjeshtërt të shoqërisë, një botë mashkullore etj.
- 1 pikë** Nëse përmend një prej rasteve të dhëna më sipër.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, përmend raste të tjera që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 8 2 pikë

Model përgjigjeje

Keqardhja: në këtë fragment shpreh keqardhjen *gruaja malësore me barrë karthjash mbi shpinë*.

OSE Keqardhje ndjen edhe autori.

Arsyeja: ajo është femër dhe është e vetmja që e kupton mjerimin shpirtëror dhe fizik të Lukes.

- Malësorja e munduar, e lodhur, që punon për mbijetesë, mundet të kuptojë thelbin e asaj që ka ndodhur me Luken.
- Në një botë mashkullore, ku gruaja ndihet në disa forma e shfrytëzuar (edhe Lukja dhe malësorja) është e pritshme që një grua të kuptojë një tjetër.
- Gruaja ia kupton hallin gruas.
- Autori ndjen keqardhje, sepse nënkuptohet pozicionimi pro Lukes, keqardhja që ai ndjen.

1 pikë Nëse gjen saktë se kush shpreh keqardhje për Luken: malësorja

1 pikë Nëse shpjegon qartë arsyen e kësaj keqardhjeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, përmend arsye që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 9 2 pikë

1 pikë horr + llëk (Nxënësi mund të japë një nga variantet e mëposhtme)

- me prejardhje;
- me prapashtesë;
- me prapashtesë me prejardhje turke.

1 pikë **Ngjyrimi stilistikor** (Nxënësi mund të japë një nga variantet e mëposhtme)
Fjala ka ngjyrim negativ:

- keqësues,
- tallës,
- përbuzës,
- keqdashës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 3 pikë

Mjetet e stilistikës: *epitetet*: të nxime, së çmendun;
metaforat: fytyrë të nxime nga vuajtja, me ata sy të marri, shikim të marrit.

Efekti: Këto figura të kursyera japin portretin e një gruaje me një dramë shpirtërore, të vuajtur, të marrë fund.

E gjithë kjo mënyrë përshkrimi krijon keqardhje dhe trishtim, etj.

2 pikë Nëse gjen **dy** figura stilistike bashkë me ilustrimet përkatëse.

dhe **1 pikë** nëse gjen vetëm **një** figurë stilistike bashkë me ilustrimin.

1 pikë Nëse shpjegon qartë efektin që shkakton mënyra e përshkrimit të saj.

0 pikë Nëse nxënësi gjen figurat pa ilustrimet përkatëse.

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11 2 pikë

Model përgjigjeje

Koha: Paragrafi i parë i këtij fragmenti është në kohën e tashme, kurse e gjithë pjesa e dytë është në kohën e shkuar (e pakryer, e kryer e thjeshtë, etj).

Stili: Në pjesën e parë spikat stili telegrafik, i thatë, i zhveshur me fjali eliptike ose mungesore, ngjason me një stil publicistik, ku autori përqendrohet vetëm në renditjen e fakteve. Në pjesën e dytë kemi rikthimin në ngjarje, në historinë e Lukes, kemi rrëfimin për ngjarjen, paraqitjen e personazheve, dialogun. Pjesa e dytë merr trajtën e tekstit letrar.

1 pikë Nëse gjen kohën e foljeve midis paragrafit të parë dhe pjesës në vazhdim.

- Koha e tashme dhe e shkuar.

1 pikë Nëse gjen ndryshimin në stil midis paragrafit të parë dhe pjesës në vazhdim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 3 pikë

Model përgjigjeje: Fjalitë që fillojnë me lidhëz bashkërenditëse shtuese.

- E Lukja, nga ana e saj, shikonte njerëzit dhe buzëqeshte.
- Dhe njerëzit filluen të lozin me fjalë, tue ia kujtue Lukes së çmendun jetën e kalueme.
- Dhe Lukja, me fytyrë të nxime nga vuajtja, me ata sy të marri me
- at hi-hi-hi, shkoi në çmendinë.
- E ajo, shikonte me at shikim të marrit dhe buzëqeshte:

Arsyeja e përdorimit: Përdorimi i lidhëzës Dhe, E (lidhëz lirike) japin idenë e vazhdimësisë, rrjedhshmërisë, i japin rrëfimit nota të lirizmit, brishtësisë etj.

2 pikë Nëse gjen dy raste fjalish të dhëna më sipër, që fillojnë me lidhëz bashkërenditëse shtuese.

dhe **1 pikë** nëse gjen vetëm një rast.

1 pikë Nëse gjen arsyen e përdorimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II Shekspiri

“Makbethi”

Pyetja 13	C	1 pikë
Pyetja 14	D	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	A	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë

Pyetja 18 4 pikë

Model përgjigjeje

Kjo skenë zhvillohet natën ose në mesnatë.

Funksioni artistik:

- Zhvillimi i skenës natën rrit **ankthin, misterin, frikën, tmerrin** te spektatori ose lexuesi.
- Nata mbart shumë të papritura, pabesi.
- Nata i vesh gjërat e zakonshme me përmasa të pazakonta (detajet, objektet, ngjarjet). Nata të parapërgatit për ngjarje të frikshme, të papritura që mund të ndodhin.
- Skenat që zhvillohen natën janë të parapëlqyera nga shkrimtarët, pikërisht për efektin sugjestionues që ato shkaktojnë.

Detajet: *kukuvajka*,

- na uroi natën e mirë,
- mos u zgjuan,
- kur flinte do ta kisha bërë vetë,
- kush fle në odën e dytë,
- qeshi në ëndërr,
- u zgjuan,
- i zuri prapë gjumi,
- mos fli më,
- gjumin,
- shambëllanëve të fjetur,
- rrobën e natës.

1 pikë Nëse shkruan skenën kur zhvillohet ngjarja.

1 pikë Nëse shpjegon **qartë** funksionin artistik.

2 pikë dhe Nëse gjen **dy** detaje nga fragmenti.

1 pikë Nëse gjen **një** detaj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 19 3 pikë

Figura e stilistikës: metafora

Interpretimi: Makbethi me krimin që kreu vrau gjumin e tij, vrau qetësinë e tij përgjithmonë. Ky varg është thirrja e ndërgjegjes së vvarë. Njeriu i me ndërgjegje të qetë fle, ai me ndërgjegje të trazuar jo.

1 pikë Nëse gjen figurën e stilistikës.

2 pikë Nëse interpreton **qartë** kuptimin e vargut.

DHE **1 pikë** nëse interpreton pjesërisht kuptimin e vargut. P.sh:

- Vrau qetësinë; OSE
- Ka një ndërgjegje të trazuar; OSE
- Nuk fle dot më pasi ka kryer krimin; OSE
- Krimi e lë pa gjumë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim (nuk ka kuptuar thelbin e veprës) ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20 1 pikë

Model përgjigjeje: Zonja Makbeth nuk e vret vetë pasi mbreti në gjumë i kujton të atin. Është një moment kur ajo shfaq dobësinë e saj.

1 pikë Nëse shpjegon arsyen pse Zonja Makbeth nuk e kreu vetë krimin.

- Mbreti në gjumë i ngjasonte të atit; OSE
- Shpreh një dobësi të sajën; OSE
- Është brenda natyrës njerëzore që edhe kriminelin të ketë një pikë të dobët; OSE
- Dobësia e vajzës për babanë; OSE
- Krahassimi me të atin sugjeron se pavarësisht dëshirës së saj për pushtet, ajo sheh te mbreti figurën autoritare që duhet respektuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 1 pikë

Model përgjigjeje: Trokitja në derë nga pikëpamja psikologjike krijon ankth, tension, frikë. Është detaj që përdoret në veprat dramatike për të treguar gjendjen e tendosur të personazhit. Kjo përcillet edhe tek lexuesi ose publiku.

1 pikë Nëse shpjegon efektin psikologjik që shkakton trokitja në derë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë

Model përgjigjeje

Gjaku në këtë tragjedi ka dy kuptime: të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm.

Gjaku në kuptimin e drejtpërdrejtë vjen si dëshmi e krimit, njollat në duart e Makbethit dhe të së shoqes janë njollat e vrasjes.

Në kuptimin e figurshëm gjaku është pasoja e krimit, simbolizon vrasjen, vdekjen, është njolla e ndërgjegjes së vrarë, është krimi që nuk shqitet.

1 pikë Nëse gjen kuptimin **e parë** që sjell imazhi i gjakut.

1 pikë Nëse gjen kuptimin **e figurshëm** që sjell imazhi i gjakut.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 3 pikë

Model përgjigjeje

Fjalët e përbëra:

- barkpërmbysur,
- trupkapitëse,
- kryeushqyesen,
- vullnetsëmurë.

Formimi:

- bark+përmbysur,
- trup+kapitëse,
- krye+ushqyesen,
- vullnet+sëmurë.

2 pikë Nëse gjen **dy** fjalë të përbëra, nga fjalët e dhëna më sipër.

dhe **1 pikë** nëse gjen vetëm **një** fjalë të përbërë, nga fjalët e dhëna më sipër.

1 pikë Nëse tregon formimin e **njërës** prej fjalëve të përbëra.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 2 pikë

Model përgjigjeje: Një teknikë e tillë, e përdorur që në antikitet, e bën aktin më të tmerrshëm përmes fuqisë së sugjestionimit. Gjërat që nuk shfaqen janë më të mistershme, rritet dramaciteti, kureshtja te spektatori.

2 pikë Nëse shpjegon **qartë** arsyen e zgjedhjes së një teknike të tillë.

dhe

1 pikë Nëse shpjegon **pjesërisht** arsyen e një zgjedhjeje të tillë.

- Rrit kureshtjen; OSE
- Nuk do të trondisë shikuesin, etj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 8 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku tregon se si autori përdor teknika të tilla si shfrytëzimi i detajeve dhe imazhet, për të dhënë thelbin e dy personazheve: Makbethit dhe zonjës Makbeth.
- shpreh qartë, përmes teknikave të tilla, se ku ndryshojnë ata të dy, cilat tipare të tyre theksohen dhe pse.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë
- përdor detaje mbështetëse
- ka qartësi mendimi

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË

2 pikë

1 pikë Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:
hyrjen
zhvillimin
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- Përmes gjuhës që përdor krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike
- ka fjalor të pasur
- stil origjinal

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm
- ka saktësi drejtshkrimore